

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-181/11

Prishtinë

29 nëntor 2012

Në çështjen juridike të

1. **T.M.**
2. **V.M.**
3. **B.M.**

përfaqësuar nga

4. **R.M.**

Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Filcheva-Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Anëtar, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/106/2011 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA08498), të datës 13 maj 2011, pas seancës së mbajtur me 29 nëntor 2012, mori këtë

AKTGJYKIM

- 1- Refuzohen ankesat e R.M., T.M., V.M. dhe B.M. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/106/, i datës 13 maj 2011.
- 2- Anulohet vendimi i Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/106/2011, i datës 13 maj 2011, për sa i takon lëndës së regjistruar në AKP me numër KPA08498.

- 3- Refuzohen kërkesat e R.M., T.M., V.M. dhe B.M..
- 4- Obligohet pala ankuese që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 80 € (tetëdhjetë euro), të cilat duhet të paguhen në Buxhetin e Kosovës brenda afatit prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përbarimit të detyrueshëm.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Me 12 janar 2007, R.M., duke vepruar në emër të tij dhe në emër të vëllezërve të tij T., V., B. dhe M.M., ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar që ata të njihen si pronarë të ngastrave të ndryshme të tokës të fituara me anë të trashëgimisë, dhe ka kërkuar ri-posedimin e tyre. Ai ka sqaruar se këto ngastra i përkisnin atij dhe vëllezërve të tij. Ai ka deklaruar se prona ishte uzurpuar si rezultat i rrethanave të viteve 1998/1999 në Kosovë dhe se data e humbjes së pronës ishte 12 qershori 1999.

Për të mbështetur kërkesën e tij, ai ka paraqitur në AKP dokumentet si në vijim:

- Aktvendimin e Trashëgimisë së Gjykatës Komunale në Klinë T.nr.14/92, i datës 4 maj 1992. Me këtë aktvendim pas vdekjes së N.M. – babait të tyre, trashigimtarë në masën trashigimore të tij - ngastrën kadastrale 1/249 dhe 24/2, në vendin e quajtur “Kaproishte” në sipërfaqe prej 14014 m², përkatësisht 6655 m², Zona Kadastrale Pjetër i Poshtëm, janë shpallur paraqitësi i kërkesës – R.M. dhe katër vëllezërit e tij T., V., B. dhe M.M..
- Në Çertifikatën mbi të Drejtën e Pronës së Paluajtëshme UL-71011027-00019, të Zyrës Kadastrale në Klinë, e datës 3 janar 2007, paluajtshmëritë e përshkruara në paragrafin paraprak janë regjistruar në emër të M.M. në cilësinë e pronarit.

Të dy dokumentet këne mund të verifikohen, sidoqoftë, është theksuar se vendimi nuk ka patur “vulën e plotëfuqishmërisë”.

Me 13 maj 2011, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) me vendimin e tij KPCC/D/A/106/2011, e ka aprovuar kërkesën si të bazuar siç vijon: Me këtë vendim është konstatuar se M.M. është pronar i ngastrës kadastrale 1/249 dhe 24/2, në vendin e quajtur “Kaproishte”, në sipërfaqe prej 14014 m², përkatësisht 6655 m², Zona Kadastrale Pjetër i Poshtëm, ndaj edhe i kthehen në posedim këto paluajtshmëri. Po kështu me këtë vendim është vendosur që çdo palë që ka uzurpuar këto prona detyrohet t'i

lirorë ato, në të kundërtën forcërisht do të dëbohen. Në fund të vendimit, KKKPK-ja ka dhënë udhëzimin juridik se ankesa kundër vendimit do të duhej të ushtrohej brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e njoftimit të palëve.

Vendimi i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës me 12 shtator 2011. Me 11 tetor 2011, ai ka paraqitur ankesë, duke deklaruar se vendimi ankimor është përfshirë me vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, ndaj për këto shkaqe dhe arsye ai ka kërkuar përmirësimin e vendimit. Kjo nga fakti se, me aktvendimin trashigimisë të Gjykatës Komonale në Klinë T.nr.14/92, i datës 4 maj 1992, pas vdekjes së babait të tyre N.M. trashigimtarë të masës trashigimore - ngastrës kadastrale 1/249 dhe 24/2, në vendin e quajtur “Kaproishte” në sipërfaqe prej 14014 m², përkatësisht 6655 m², Zona Kadastrale Pjetër i Poshtëm, janë shpallur R.M. dhe katër vëllezërit e tij T., V., B. dhe M.M.. Më tutje ai i propozon Gjykatës Supreme që të vërteton pronësinë se secili nga këta trashëgimtar janë pronar në 1/5 e pjesës ideale të këtyre ngastrave.

Meqenëse Gjykata Supreme i ka kërkuar R.M. të paraqesë autorizimin e dhënë nga vëllezërit e tij, ai i ka paraqitur Gjykatës autorizimet e dhënë nga vëllezërit e tij T., V. dhe B. M.. Sidoqoftë, sipas R.M., M.M., në emërin e të cilit ngastra ishte regjistruar, ka refuzuar që t'i jap atij autorizimin.

Arsyetimi ligjor:

Gjykata vëren se Paraqitësit e kërkesave/Ankuesit janë R., T. dhe B.M.. Paraqitësi i kërkesës R.M. ka paraqitur autorizime valide të dhënë nga tre vëllezërit e tij. Sidoqë të jetë R.M., nuk i ka paraqitur Gjykatës autorizimin e dhënë nga vëllau i tij M.M.. Në përputshmëri me këtë, M.M. asnjëherë nuk ka qenë palë në procedurë, prandaj R.M. as si paraqitës i kërkesës dhe as si ankues nuk ka qenë i autorizuar të përfaqësojë atë.

Lejueshmëria e ankesave

Ankesat janë të lejueshme. Ankuesit kanë interes ligjor në ankesa meqë vendimi i KKKPK-ës ka qenë në dëm të tyre.

Gjykata vëren se AKP-ja përmban një raport sipas së cilit paraqitësi i kërkesës R.M. gjatë komunikimit me Zyrtarin e AKP-ës ishin pajtuar që kërkesa e paraqitur të procedohet vetëm në emrin e vëllaut të tij M.M. (i cili nuk i kishte dhënë atij autorizimin, prandaj, sido që të jetë R.M. nuk kishte të drejtë të paraqiste kërkesë në emër të vëllaut të tij). Kjo deklaratë e R.M., sidoqë që të jetë nuk është tërheqje ose ndryshim i kërkesës (Neni

275ff, 261 i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore). Neni 99.1 i LPK-ës parasheh se “*kërkesa, përgjigjja në kërkesë, ankesat dhe deklaratat e tjera, propozimet dhe njoftimet të cilat janë bërë jashtë gjykatës duhet të paraqiten më shkrim (shkresat)*”. Këto dispozita ligjore duhet të aplikohen përshtatshëm në procedurën para Kolegjit të Apelit të AKP-ës të Gjykatës Supreme (Neni 13.5 i Rregullorës së UNMIK-ut 2006/50 e plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079). Meqenëse R.M. nuk ka paraqitur me shkrim tërheqjen e kërkesës së tij të paraqitur, kërkesa qëndron ashtu siq është shprehur në formën e kërkesës: Të vërtetohet se të gjithë pesë vëllezërit kanë provuar të drejtën e tyre të pronësisë në 1/5 e pjesës ideale për secilin dhe t’iu ipet në posedim ngastra. Prandaj, KKPK-ja duke konfirmuar të drejtën e pronësisë së M.M. në 1/1 e pjesës së parcelës, ka vendosur në dëm të paraqitësve të kërkesës, të cilët kanë kërkuar që të njihen si pronar në 1/5 e pjesës ideale për secilin.

Në lidhje me meritat

E drejta e pronësisë e ankuesve

Sidoqë të jetë, ankuesit nuk kanë provuar se ata janë pronarët e ngastrave. Ngastrat nuk ishin regjistruar në emërin e tyre. Aktvendimi mbi trashëgimin i vitit 1992 nuk ofron prova të mjaftueshme. Ky vendim ka mundur të verifikohet si i tillë por nuk ka mundur të sigurohet se vendimi ishte përfundimtar. Prandaj gjykata nuk mund të përjashtoj se ky vendim është apeluar. Dhe edhe nëse vendimi ishte përfundimtar Gjykata nuk mund të përjashtoj se vëllezërit më vonë kanë gjetur një zgjidhje tjetër dhe kanë ndarë ngastrat në një mënyrë tjetër në mes tyre.

Mbi bazën e këtyre rrethanave ankuesit nuk kanë provuar të drejtën e tyre të pronësisë në ngastrat kontestuese.

E drejta e pronësisë e M.M.

Sidoqë të jetë, Gjykata, duhet të anuloi vendimin e ankimuar të KKPK-ës për sa i takon kërkesës KPA08498 me të cilën e drejta e pronësisë në 1/1 pjesë të M.M. është konfirmuar. Ankuesit pranojnë vetëm pronësinë e M.M. në 1/5. Prandaj edhe vendimi për konfirmimin e të drejtës së pronësisë (në pjesën 1/1) të M.M..

Sidoqë të jetë, ankuesi R.M. nuk kishte të drejtë të përfaqësonte M.M., i cili refuzoi të jepte atij autorizimin, Gjykata nuk mund të konfirmoj ndonjë të drejtë në të mirë të M.M.. Prandaj vendimi i ankimuar duhet të anulohet.

Shpenzimet e procedurës:

Në bazë të Shtojcës III, nenit 8.4 të Urdhërësës Administrativ (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit. Si pasojë, regjimi normal i pagesës së taksës gjyqësore të paraparë më Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA Nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore për procedurat para Kolegjit të Apelit.

Kështu që, tarifatat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (Neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për marrjen e aktgjykimit (Nenet 10.21 dhe 10.1 të UA 2008/2), duke pasqyruar se vlera e pronës në fjalë me arsye mund të vlerësohet në 8.000€ : 50€ (gjysmë pjesa e tarifës sipas numrit të tarifës 10.1, por jo më shumë se 30 €).

Secili nga ankuesit duhet të paguajnë të njëjtën pjesë të tyre, € 20 (neni 459.1 i LCP).

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga pala ankuese që ka humbur rastin. Në përputhje me nenin 46 të Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, afati për pagesën e taksave në fjalë nga personi i cili ka vendqëndrim ose vendbanim jashtë vendit nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë e më i gjatë se 90 ditë. Gjykata vendos që në rastin tanishëm tarifatat gjyqësore duhet të paguhen nga pala ankuese brenda 90 ditëve nga dita e dorëzimit të aktgjykimit. Neni 47.3 parasheh se në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, pala duhet të paguajë një gjobë. Nëse pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë atëherë bëhet zbatimi i detyrueshëm i pagesës.

Këshillë juridike:

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Elka Filcheva-Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX-it